



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KUKËS

VENDIM

Nr. 72 Datë 24.12.2021

PËR

MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2022-2024 sipas FPT

Këshilli Bashkiak Kukës, në mbledhjen e tij të datës së mësipërme, pasi shqyrtoi projekt-vendimin e paraqitur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, si dhe bazuar në ligjin Nr.139/2015, të miratuar me datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 8/2, 9/1/1.3/c, 54/dh, 55/3, ligjin Nr.44/2015, të miratuar me datë 30.04.2015 “Kodi i Proçedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, ligjin Nr.68/2017, të miratuar me datë 27.04.2017 “Per financat e veteqeverisjes vendore”, nenet 7 dhe 48, ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, (i ndryshuar), ligjin Nr.10 296, date 08.07.2010 “Per menaxhimin financiar dhe kontrollin”, (i ndryshuar), Ligjin nr. 115/2021 datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, pika 82 e udhëzimit të Ministrise se Financave Nr.23, datë 22.11.2016 “Për proçedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, Udhëzimin Nr. 7, datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2022-2024” Udhëzimin Plotësues Nr.20, datë 09.07.2021 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2022-2024”, Shkresës Nr.18976 prot datë 29.10.2021 “Dërgohet për njoftim transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale, për vitin 2022”,

VENDOSI

1. Programin Buxhetor Afatmesëm 2022 - 2024 sipas FPT-së dhe Relacionit bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut.

KRYETARI I KËSHILLIT
ANILDA BIBA

